



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 184, datë 13.12. 2011**

**PËR  
DISA SHTESA NË RREGULLOREN “PËR TARIFAT E LICENCIMIT DHE  
FUNKSIONIMIT TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE, DEPOZITARIT DHE  
AGJENTIT TË FONDEVE TË PENSIONIT VULLNETAR”**

Në bazë dhe për zbatim të paragrafit (3), të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 128 të “Kodit të Procedurës Administrative” me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren “Për tarifatat e licencimit dhe funksionimit të shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 18/1, datë 25.02.2010” e ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Elisabeta GJONI**

**Në rregulloren “Për tarifat e licencimit dhe funksionimit të shoqërisë administruese, depozitarit dhe agjentit të fondeve të pensionit vullnetar”, të miratuar me vendimin nr. 18/1, datë 25.02.2010, të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:**

- 1. Pas pikës a, të nenit 5 “Tarifa për dhënie licencë apo autorizim”, shtohet pika (a/1) me përmbajtje si më poshtë:**

*“a/1) shoqëria administruese për fondet e pensionit vullnetar, e cila e shtrin veprimtarinë edhe në administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 50.000 lekë.”*

- 2. Pas pikës b, të nenit 5 “Tarifa për dhënie licencë apo autorizim”, shtohet pika (b/1) me përmbajtje si më poshtë:**

*“b/1) Depozitari, i cili e shtrin veprimtarinë edhe si depozitar i sipërmarrjeve të investimeve kolektive, detyrohet të paguajë për llogari të Autoritetit shumën prej 30.000 lekë.”*